



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality Assambly
Hani i Elezit



01/Nr. 3095 /2023
Data : 07.04.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e tretë -III- për vitin 2023 e Komitetit për Politik dhe financa , mbajtur me datë 16.02.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Ajete Berisha** (Udhëheqëse e Personelit), **Sevime Bajrami** (Kryesuese e Komisionit të Aksionarëve), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Vjollca Livoreka** (Zyrtare për Barazi Gjinore), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës.
3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.
4. Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.
5. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.
6. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2022.
7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.
8. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç pikave të rregullta të rendit të punës të cilat i kemi përcjell ju kemi dërguar edhe dy materiale shtesë , njëri ka të bëjë për miratimin e propozim vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave dhe materiali tjetër ka të bëjë për propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale. Pikat shtesë të cilat ua kemi përcjell hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:-

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
2. **Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës.**
3. **Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.**
4. **Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.**
5. **Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.**
6. **Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2022.**
7. **Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.**
8. **Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.**
9. **Propozim vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.**
10. **Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale**
11. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Refet Kalisi thekson:- faqe katër te pika e rendit të punës të ndryshme diskutimi im ka qene :- kompanisë “Preni” ju ka ndërprerë kontrata dhe është mirë me biseduar për shkak se edhe ata janë taksa pagues të komunës sonë dhe janë pesëdhjetë punëtorë që duhet të largohen nga puna ju si bord është mirë që ta bisedoni që mos me ja ndërprerë kompania “Sharrcem” kontratën. Të përmirësohet numri i punëtorëve që është shënuar pesëdhjetë dhe të jetë numri i punëtorëve pesëmbëdhjetë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. **Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës.**

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjan thekson:- te neni tre i këtij propozim vendimi e keni shpjegimin për Plotësim ndryshimi e Statutit të Komunës sipas propozimeve të dy drejtorive do të bëhet në nenin 67 Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ndryshohet në Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizëm, gjithashtu shtohen kompetencat dhe detyrat e turizmit, ndërsa neni 63 Drejtoria për Arsim Kulturë Rini dhe Sport, ndahet Drejtoria e Arsimit, me kompetenca dhe detyra të Arsimit shtohet një nen tjetër dhe drejtori tjetër Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

Sherif Berisha thekson:- a e keni pa të arsyeshme për me shtuar edhe një drejtori apo për me hequr një drejtori nëse nuk ka nevojë dhe me u shtuar drejtoria e ambientit për shkak se ndarja e drejtorisë së arsimit nëse është bërë për me shtuar pozita dhe për me rehatuar dikend nuk e shohë të arsyeshme për ndryshe kemi nevojë për drejtorin e ambientit .

Sevdi Dernjan thekson:- sa i përket asaj që u potencua që drejtoria po ndahet për me rehatuar dikend nuk qëndron kjo, ndërsa propozimet janë prej drejtorive përkatëse. Për me u realizuar kjo ndoshta do të jetë problem për shkak se duhet me u ndarë buxhet prej nivelit qendrorë por ne jemi duke tentuar me bërë këtë, ndërsa për me u bërë edhe drejtoria e ambientit është problem për shkak se jemi komunë e vogël.

Sherif Berisha thekson:- te drejtoria e bujqësisë mund të shtohet edhe turizmit si punë shtesë ndërsa pjesa e ambientit me qenë te zhvillimi ekonomik .

Sevdi Dernjan thekson:- drejtoria e urbanizmit e ka edhe ambientin .

Refet Kalisi thekson:- kjo drejtori kishte shumë kompetenca dhe shumë e ngarkuar kjo drejtori dhe të gjitha përgjegjësit i kalojëshin kësaj drejtorie . Unë mendoj se drejtori kemi boll për shkak se jemi komunë shumë e vogël dhe shtimi edhe i një drejtori më doket e tepërt sepse duhet të kemi buxhet për ato drejtori.

Nora Xhoni thekson:- komuna jon dhe disa komuna të vogla nuk e kanë të ndarë këtë drejtori se në përgjithësi komunat e tjera e kanë të ndarë drejtorin e kulturës prej drejtorisë së arsimit . Kjo drejtori është diskutuar edhe në mandatin e kaluar për me u formuar.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMIN PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PLOTSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- pas gjithë analizave që i ka bërë NPL Pastrimi jemi dakorduar që me përcjell për plotësim ndrysh këtë rregullore. Për ekonomi familjare është propozuar të jetë 6.50 €, po ashtu është propozuar edhe ngritje për bizneset diku 30 % për shkak se është ngritur çmimin i deponisë dhe karburanteve . Ju njoftojë së të gjitha komunat kanë bërë ngritje për këtë çështje.

Sherif Berisha thekson:- si lëvizje vetëvendosje nuk jemi për me i ngritur çmimet por jemi për me zvogëluar këtë shumë. Unë jam që të bisedohet dhe të bëhet ngritja pagave për punëtorët e NPL “Pastrimi” .

Arsim Dernjani thekson:- nuk mund të ngritën pagat e punëtorëve nëse ulen çmimet për bartje të mbeturinave .

Refet Kalisi thekson:- sa i përket ngritjes së çmimit unë jam që të bëhet ngritja për shkak se nëse nuk rriten shërbimet nuk mund të ketë ngritje të pagave . Kompania është duke e bërë një punë shumë të mirë dhe çmimi prej 6.50 € nuk është edhe shtrenjtë sepse punët janë duke u kryer mirë.

Kryesuesi thekson:- unë mendoj se është e nevojshme ngritja e çmimit për shkak se edhe dërgimi i mbeturinave në deponi tash duhet të paguhet me ngritje, është ngritur çmimi i naftës pastaj defektet janë të kushtueshme. Kompania është duke i kryer punët mirë. Kjo do të diskutohet edhe në debat publik dhe propozimet e qytetarëve do të përcillen në kuvend. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RREGULLORJA PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti i progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- të gjitha të dhënat i kemi paraqitur në detale për çështjen e raportit të progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit për vitin 2021.

Refet Kalisi thekson:- ju përgëzoj për realizimin e rekomandimeve por të shohim si do të shkojnë edhe për vitin 2022. Llogaritë e arkëtueshme janë të grumbulluara me vite të tëra dhe a keni ndonjë plani si me i inkasuar .

Lindita Ballazhi thekson:- këtë raport e deklarojmë edhe në zyrë kombëtare të auditimit dhe raporti është hartuar nga të gjitha departamentet ku ka pasur të gjetura. Ne jemi munduar për me i inkasuar llogaritë e arkëtueshme duke ju ofruar mundësi qytetarëve që të bëjnë pagesa me këste në tatim në pronë, e njëjta do të vazhdojë në këtë vit dhe viteve të tjera.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PROGRESIT TË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Raporti i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Raporti i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjan thekson:- në këtë informatë i keni të shënuara çështjet të cilat i kemi diskutuar në takimet e KKSBB-së.

Refet Kalisi thekson:- shqetësuese është çështja e vjedhjeve nëpër shtëpi të cilat kanë ndodhur edhe pse kjo është çështje e policisë. Çështja e qenve endacak është problem në tërë Kosovën nuk është vetëm në Han të Elezit a ka ndonjë projekt për trajtimin e tyre.

Sevdi Dernjan thekson:- çështja e qenve endacak është një problem në tërë territorin e Kosovës dhe personalisht isha në takim me kryetarët e komunave dhe me kryeministrin e Kosovës është trajtuar kjo temë. Komuna nuk ka buxhet për trajtimin e qenve endacak për shkak se ka një kosto të lartë, mirëpo kryeministri i Kosovës ka premtuar që do të merr hapa konkret drejt realizimit të këtij projekti por nuk ka dhënë detaje për këtë çështje. Çështjen e vjedhjeve e kemi diskutuar në KKSBB dhe kemi kërkuar nga policia që më shumë të jetë në teren .

Sherfi Berisha thekson:- çështja e fëmijëve të cilët ditën e premte në orën e gjashtë apo të shtatën shkojnë në Xhami është mirë me diskutuar këtë çështje.

Sevdi Dernjan thekson:- është çështje që i përket drejtori së arsimit por që na prekë të gjithëve do ta diskutojmë në KKSB.

Kryesuesi thekson:-pavarësisht takimeve që i ka mbajtur KKSB-ja nuk shohë që ka pasur ndonjë rezultat për temat të cilat i kanë diskutuar që mendoj që është shqetësim për banorët e komunës së Hanit të Elezit për shkak se bëhen vjedhjet vazhdimisht dhe hetimet vazhdojnë e nuk ka rezultate. Ne e dimë që ekzekutivi nuk ka kompetencë me bërë në punë të policisë përveç se me i diskutuar këto çështje por rezultate nuk ka. Është rasti i dukurive negative në Han të Elezit dhe organet kompetente që i hetojnë këto raste nuk janë adekuatë. Duhet të bëhemi bashkarisht të gjithë pozitivë e opozitivë duke i përdorur format më të mirë që me mundur me zvogëluar këtë dukuri .

Sherfi Berisha thekson:- ka ndodhur një rast në qendër të Hanit të Elezit që pronari e zenë hajnin brenda dhe nuk dinë se çka me bërë me të, ndërsa polica vjen me vonesë ne e dimi çështjen e legjislacionit por policia duhet të intervenon e jo me pritë tërë natën.

Sevdi Dernjan thekson:- në KKSB janë diskutuar këto çështje por ne nuk kemi rol që të ndërmarrim hapa konkretë ndaj kësaj dukurie ne mund të japim rekomandime . Është mirë që t'i motivojmë shoqëritë civile që ta ngrisin zërin për këtë çështje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATATA PËR AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Informatë për aktivitetet e këshillave të fshatrave të komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natrya Kalisi thekson:- përveç materialit të cilin e kemi përcjell diçka të veçantë nuk kam.

Refet Kalisi thekson:- a janë duke funksionuar këshillat e fshatrave.

Natrya Kalisi thekson:- mbahen takimet vazhdimisht dhe i keni në raport të shënuara, komuna është duke u munduar me ju dhënë zgjidhje kërkesave të tyre që bëhen.

Sherfi Berisha thekson:- kryetari i këshillit të Hanit të Elezit a është aktiv për shkak se Hani i Elezit meriton me pasur një kryetarë të qendrës e jo prej Lagjes Re për shkak se duhet të jetë aktiv për problemet që janë.

Natrya Kalisi thekson:- kjo është varur te pjesëmarrja e qytetarëve, njoftimi ka qenë publik dhe qytetarët po hezitojnë për shkak se është një lloj përgjegjësie.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATATA PËR AKTIVITETE E KSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Propozim vendim për miratimin e iniciativës për bashkëpunim ndërkomunal ndërmjet komunave të regjionit Gjilanit dhe Ferizajt në fushën e menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- kjo iniciativë është bërë në kuadër të gjitha komunave të regjionit të Gjilanit dhe Ferizajt . Në material janë të shënuara të gjitha detajet.

Refet Kalisi thekson:- a mos ka ndonjë marrëveshje për bashkimin e kompanive sepse nëse është për me bërë si kompani regjionale jam kundër.

Arsim Dernjani thekson:- nëse një deponi hapet në Ferizaj apo në Gjilan me këtë marrëveshje kemi të drejtë me i dërguar mbeturinat .

Sherif Berisha thekson:- te pika numër katër shënon kryetari i komunës së Kaçanikut dhe ekipi ndër komunal është mirë të përmirësohen për shkak se është gabim teknik.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E INICIATIVËS PËR BASHKPUNIM NDËR KOMUNAL NDËRMJET KOMUNAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

10. Propozim vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të parcelave kadastrale.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- bëhet fjalë për shpallen me interes të përgjithshëm të disa parcelave në territorin e komunës. Në material janë të shënuara të gjitha parcelat që do të shpallen me interes të përgjithshëm dhe arsyeja se pse këto prona i kemi shpallur me interes të përgjithshëm.

Refet Kalisi thekson:- a prekën pronat private te mbikalimi që planifikohet të ndërtohet.

Nexhmedin Daci thekson:- po preken pronat private po i mbetet kompanisë “Sharrcem” si obligim kjo çështje. Janë edhe tri parcele në emër të z.Emin Kalisi që parashihet ndërtimi i shkollës fillore. Po ashtu janë edhe gjashtë parcele te Ura e Fezës që parashihet mbikalimi që projektin e kemi bërë dhe nëse bëhet realizimi i projektit duhet të zhvillohen procedurat e shpronësimit.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR SHPALLJEN ME INTERES TË PËRGJITHSHËM TË PARCELAVE KADASTRALE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

11. Të ndryshme

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoj në ora 12:39.

Procesmbajtësi

Armi Bushi



**Kryesuesi i Komitetit
Florim Shkreta**